

Komuna e Ferizajt: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Ferizajt udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetar aktual i kësaj komune është Agim Aliu. Ferizaj ka mbajtur zgjedhje në gjysmën e parë të vitit 2012, pas shpalljes së aktgjykimit ndaj ish Kryetarit të kësaj komune Bajrush Xhemajli.¹ Zgjedhjet janë mbajur vetëm për Kryetar Komune, ndërsa Kuvendi Komunal ka vazhduar mandatin e fituar në zgjedhjet e 2009.
2. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave kjo komunë ka 108.610 banorë, duke u kategorizuar kështu si komuna e tretë më e madhe në vend, pas Prishtinës dhe Prizrenit.²
3. Komuna e Ferizajt aktualisht ka dhjetë drejtori komunale. Kuvendi komunal përbëhet prej 42 këshilltarëve. Në zgjedhjet e 2009, 15 vende i ka fituar Partia Demokratike e Kosovës (PDK), shtatë vende Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), gjashtë vende Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), pesë vende Aleanca Kosova e Re (AKR), tri vende Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe nga një vend në Kuvendin Komunal e kanë fituar Partia e Drejtësisë (PD), Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), Partia Socialiste e Kosovës (PSK), Partia “Ora” dhe Bashkimi Demokratik i Ashkalive.
4. Nga hulumtimi i UNDP (“Mozaiku i Kosovës 2012”), një përqindje e lartë (87%) e qytetarëve të anketuar në Ferizaj beson se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre. Vetëm 5% e tyre në krahasim me mesataren e kosovarëve

¹ Bajrush Xhemajli është gjetur fajtor për shkaktrim të rrezikut me pasojë vdekjen e një personi në komunikacion, i shkakuar nga pakujdesia dhe mos respektimi i rregullave të komunikacionit.

² Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Fq 134. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

15%, mendojnë se këto probleme mund të zgjidhen nga pushteti qendror.³

5. Nga hulumtimi i zhvilluar në fund të vitit 2009 nga Instituti GAP, problemet më të mëdha që kanë pasur banorët e Komunës së Ferizajt kanë qenë: mungesa e hapësirave të gjelbëruara, funksionalizimi i mbikalimit mbi hekurudhat e qytetit, prezenca e madhe e mbeturinave si dhe trafiku i dendur.⁴

Problemet kryesore të Komunës së Ferizajt 2013

- 1. Reduktimet e ujit të pijshëm.** Vendbanimet e Ferizajt përballen me reduktime të shpeshta dhe të gjata të ujit të pijes. Ky problem është shfaqur edhe në qytet, e veçmas në periferi të qytetit dhe në fshatrat e kësaj ane. Disa rajone të kësaj komune kanë problem me kapacitetin e dobët të ujit, si në fshatin Mirash, Komogllavë, Slivovë, Mirosalë. Të vetmet vendbanime në Ferizaj të cilat akoma nuk e kanë të rregulluar sistemin e ujësjellësit janë Starosellë, Sojevë dhe Bibaj. Të dhënat e UNDP-së tregojnë se furnizimi i ujit është mjaft problematik në Ferizaj. Rreth 40% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik pohojnë se kanë furnizim të pakufizuar me ujë, në krahasim me mesataren e Kosovës prej 42%. Tre përqind e familjeve të Ferizajt raportuan se kanë pasur ndërprerje të furnizimit me ujë për 1 deri në 4 orë në ditë, 8% prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse 47% kanë përvojë me ndërprerje më të gjata se 11 orë në ditë.⁵
- 2. Kanalizimet.** Territori i Komunës së Ferizajt përgjithësisht është i mbuluar me sistem të kanalizimit. Në disa rajone edhe përkundër ekzistimit të këtij rrjeti, ai është jo funksional, duke shkaktuar kundërmime dhe telashe për banorët. Kjo gjendje haset në fshatrat Starosellë, Greme, Sazli, Gërlic, Varosh.
- 3. Prerja e pyjeve.** Dëmtimi i pyjeve nga prerja ilegale e tyre vlerësohet problem i radhës në Komunën e Ferizajt. Kjo dukuri është e shtrirë veçmas në zonën e ashtuquajtur brezi i maleve

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 34. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁴ Instituti GAP. Raporti Komunal. Komuna e Ferizajt. Nëntor 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/66152_Ferizaji-raporti%20komunal.pdf

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 31. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

të Jezercit, vargu i maleve të Sharrit në drejtim të Shtërpcës si dhe vargmalet e Zhegocit.

- 4. Trotuaret dhe nënkalimet.** Mungesa e trotuareve është një problem që shfaqet më shumë në zonat rurale dhe në afërsi të shkollave. Në fshatin Rahovicë nxënësit për shkak të mungesës së trotuarit ecin rrugës së automjeteve. Ndër vendet që duhet intervenuar për të shtuar sigurinë në rrugë është tek Prelezi i Jerlive. Nevoja e ndërtimit të një nënkalimi apo mbikalimi konsiderohet e domosdoshme (në këtë vend nga aksidentet në dhjetë vitet e fundit kanë humbur jetën disa qytetarë).
- 5. Degradimi i qytetit, rrënimi i objekteve të trashëgimisë kulturore.** Ndërtimet e egra janë bërë në ato vende kur më parë kanë qenë vende të shfrytëzuara për zhvillim kulturor. Ky degradim vazhdon të bëhet e aq më keq këto ndërtime mendohet të bëhen aty ku janë ndërtesa të vjetra që do të konsideroheshin trashëgimi kulturore. Është menduar të rrënohet Xhamia e Madhe, e vjetër për më shumë se 85 vite që përveç rëndësisë kulturore ka edhe një rëndësi për tolerancë e bashkjetesë meqë gjendet në të njëjtin oborr me kishën ortodokse-serbe. Në vend të kësaj xhamie është paraparë të ndërtohet një qendër e madhe tregtare si dhe xhamia mbi të.


Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Mbrojtja e pyjeve dhe funksionalizimi i bifurkacionit.** Bashkëbiseduesit kanë kërkuar nga autoritetet e ardhshme të komunës që mos të lejojnë të bëhet prerja e pyjeve, si dhe të punohet në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e një fenomeni të rrallë siç është Bifurkacioni i lumit Nerodime në Ferizaj.
- 2. Objektet e vjetra të bibliotekave dhe teatër profesionist i qytetit.** Ferizaj është njohur për numrin relativisht të madh të bibliotekave. Për veç në qytet, objektet e bibliotekave kanë ekzistuar edhe në fshatrat si Gaçkë, Komogllavë, Talinoc të Muhaxherëve, Nerodime dhe Babush. Këto dy të fundit janë djegur gjatë kohës së luftës. Bashkëbiseduesit në këtë komunë kanë konsideruar se objektet ekzistuese duhet mirëmbajtur dhe promovuar si vlerë e qytetit. Njësoj i vlefshëm konsiderohet objekti i teatri profesionist të qytetit.

Trendet Buxhetore në Komunën e Ferizajt

Në vitin 2013, Komuna e Ferizajt ka planifikuar 20.8 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, buxheti i kësaj komune është rritur për 4.2 milion euro (27%). Kjo komunë ka realizuar 3.2 milion euro të hyra vetanake në vitin 2012 apo 256 mijë euro më pak krahasuar me vitin paraprak. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁶ ka gjetur se shuma e borxhit e grumbulluar e tatimit në pronë gjatë viteve është 6.5 milion euro. Komuna e Ferizajt⁷ ka rreth 59 mijë prona ndërsa 50% e tatimpaguesve janë të rregullt, 40% të pjesërishëm dhe 10% nuk i kryejnë fare obligimet.

Figura 1. Buxheti i Komunës së Ferizajt- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?ferizaj/2013#/~ferizaj>

⁶ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Ferizajt Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 04 Shtator 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KFE_2012_Shqip_797958.pdf

⁷ Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, Komuna e Ferizajt, Përgjigje e ndaj kërkesës së Institutit GAP. 16 Gusht 2013

Nëse krahasojmë trendet e ndarjeve buxhetore, në grafikonin e mëposhtëm shohim se përveç kategorisë së “pagave dhe mëditjeve” që ka shënuar një ngritje, kategoritë tjera nuk kanë pasur ndonjë ndryshim të theksuar. Kur jemi tek shpenzimet, Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 ka gjetur se kontrollet e shpenzimeve në komunën e Ferizajt nuk funksionojnë.

Figure 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010- 2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016, shohim se komuna planifikon të ketë një rritje të lehtë të të hyrave vetanake, ndërsa shpenzimet do të vazhdojnë të dominohen nga pagat dhe mëditjet pa ndonjë rritje të theksuar në kategoritë e tjera të shpenzimeve.

Tabela 1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2014- 2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	23.256.296	23.880.179	24.372.770
Të hyrat vetanake	3.807.300	3.921.519	3.999.949
Grantet	19.448.996	19.958.660	20.372.821
Shpenzimet Totale	23.256.296	23.880.179	24.372.770
Pagat dhe Mëditjet	11.050.000	11.195.456	11.257.421
Mallrat dhe Shërbimet	1.850.000	1.890.000	1.900.000
Shpenzimet Komunale	350.000	400.000	420.000
Subvencionet dhe Transferet	750.000	800.000	900.000
Shpenzimet Kapitale	9.256.296	9.594.723	9.895.349

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Ferizajt është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.